



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.24/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli- kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj-anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës jo qeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 7 qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.06.2025, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.24/2026, e datës 04.06.2026, e parashtruar nga Organizata jo qeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 7 qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datën 04.06.2026 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizata jo qeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në të cilën pretendohet se në rrugën “Fehmi Lladrovci”, tek mbikalimi i këmbësorëve që gjendet tek vendi i njohur si rrethi i flamurit është hasur vendosja e një baneri të madh me fotografinë dhe emrin e kandidates për deputete nga radha e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, znj. Jehona Lushtaku. Theksojnë se me këtë veprim janë cenuar rregullat e fushatës zgjedhore përkatësisht neni 34 paragrafi 1, nen paragrafi 1.2. Kanë kërkuar nga PZAP që ankesën ta pranoj si të bazuar dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) t’i shqiptoj sanksion në përputhje me legjislacionin për zgjedhjet.

Si dëshmi kanë bashkëngjitur fotografi të posterëve.

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.06.2026, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) theksojnë se e kundërshtojnë ankesën e parashtruar nga Organizata jo

qeveritare KDI, pasi vendosja e materialit zgjedhor është bërë pas marrjes së të gjitha pëlqimeve dhe autorizimeve të nevojshme nga institucionet kompetente. Kandidatja e përmendur në ankesë më datë 13.05.2026, i është drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës me kërkesë për shfrytëzimin e lokacionit të cekur në ankesë për vendosjen e materialit zgjedhor. Pas shqyrtimit të kërkesës Drejtoria e Shërbimeve Publike kanë njoftuar se lokacioni në fjalë është aset nën administrimin dhe menaxhimin e Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB), dhe për këtë arsye çështjen e kanë përcjell tek institucioni kompetent.

Tutje theksojnë se më datë 26.05.2026, kandidatja e përmendur ka paraqitur kërkesë zyrtare përmes adresës elektronike zyrtare të NPB-së, duke kërkuar pëlqim për vendosjen e materialit zgjedhor në lokacionin përkatës. Në përgjigje NPB ka dhënë pëlqimin e saj zyrtar, duke e autorizuar vendosjen e posterit vetëm në pjesën e lokacionit të përcaktuar në pëlqim. Theksojnë se kanë vepruar në përputhje të plotë me autorizimin e dhënë dhe materiali zgjedhor është vendosur pikërisht në hapësirën e lejuar nga NPB, pa tejkalluar kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në pëlqim, pra se nuk qëndron pretendimi për shfrytëzimin e paautorizuar të hapësirës publike, pasi ekziston një zinxhir i qartë institucional i veprimeve: kërkesa fillestare në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, referimi tek institucioni kompetent NPB, kërkesa zyrtare drejtuar NPB-së dhe pëlqimi i dhënë nga e njëjta. Kanë kërkuar nga PZAP që ankesën ta refuzoj si të pabazuar.

Si dëshmi në ankesë kanë bashkangjitur provat si në vijim:

-Kërkesa e datës 13.05.2026 e kandidates Jehona Lushaku drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

-Kërkesa e datës 26.05.2026 drejtuar Ndërmarrjes Publike Banesore përmes emailit zyrtar

-Pëlqimi nga Ndërmarrja Publike Banesore për vendosjen e materialit zgjedhor në pjesën e autorizuar të lokacionit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësues - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore të organizatës jo qeveritare KDI dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LDK, vlerësoj se pretendimet e palës ankuese janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli ka gjetur se në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK kanë vërtetuar faktin se me datë 13.05.2026, kandidatja për deputete nga radha e subjektit politik LDK, Jehona Lushaku Sadriu, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike ka paraqitur kërkesë për shfrytëzimin e hapësirës publike. Tutje më datën 26.05.2026 ka dërguar email pranë Ndërmarrjes Publike Banesore me kërkesë për

shfrytëzimin e hapësirës tek mbikalimi afër shkollës së mjekësisë ‘Dr. Ali Sokoli’, në Prishtinë. Në emailin zyrtar të dërguar nga Ndërmarrja Publike Banesore, me të cilën i aprovohet pjesërisht kërkesa dhe lejohet vendosja vetëm në anën e poshtme të mbikalimit nga rrethi i flamurit në drejtim të rrethit të spitalit, për periudhën kohore prej 26.05.2026 deri më 06.06.2026.

Nga provat e bashkëngjitura në përgjigje në ankesë shihet se posteri me fotografinë e kandidatës për deputete nga radha e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është vendosur në anën e poshtme të mbikalimit, afër shkollës së mjekësisë ‘‘Ali Sokoli’’, në përputhje me aprovimin e lëshuar nga NPB.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se ‘‘vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse’’, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesë nga parashtuesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZP.Anr.24/2025 më datë 06.06.2026

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.